

20240661471

---

**L I G J**  
**I NDALIMIT TË PRAKTIKAVE TË PADREJTA TREGTARE NË ZINXHIRIN E**  
**FURNIZIMIT TË PRODUKTEVE BUJQËSORE DHE USHQIMORE (\*)**

**KREU I**  
**DISPOZITAT THEMELORE**

**Lënda**

Neni 1

Me këtë ligj përcaktohen rregullat dhe masat për parandalimin e imponimit të praktikave të padrejta tregtare, të cilat devijojnë nga sjellja e mirë tregtare, përcaktohen praktikat e padrejta tregtare në zinxhirin e furnizimit të produkteve bujqësore dhe ushqimore, me imponimin e të cilave shfrytëzohet fuqia e konsiderueshme negociuese e blerësit në raport me furnizuesit e tij, procedurat për përcaktimin e praktikave të padrejta tregtare, si dhe bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve kompetente për zbatimin e mbikëqyrjes mbi zbatimin e praktikave të padrejta tregtare.

**Zbatimi**

Neni 2

(1) Ky ligj zbatohet në shitjen e produkteve bujqësore dhe ushqimore ku furnizuesi dhe blerësi janë të themeluar në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në vendet anëtare të Bashkimit Europian ose në vende të treta.

(2) Ky ligj zbatohet edhe në shërbimet e ofruara nga blerësi ndaj furnizuesit në pajtim me nenin 8 të këtij Ligj.

(3) Ky ligj zbatohet në marrëveshjet për furnizimin e produkteve bujqësore dhe ushqimore që lidhen ndërmjet blerësve dhe furnizuesve.

**Marrëdhëniet juridike në të cilat nuk zbatohet ligji**

Neni 3

Ky ligj nuk zbatohet në marrëdhëniet ndërmjet furnizuesve dhe konsumatorëve, në lidhje me shitjen e produkteve bujqësore dhe ushqimore.

---

\* Ky ligj harmonizohet me Direktivën (BE) 2019/633 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, të 17 prillit të vitit 2019 mbi praktikat e padrejta tregtare në marrëdhëniet midis ndërmarrjeve në zinxhirin e furnizimit bujqësor dhe ushqimor, numri CELEX 32019L0633

**Domethënia e termave**

Neni 4

(1) Terma të veçantë që janë përdorur në këtë ligj e kanë domethënien si vijon:

1. **“Produktet bujqësore dhe ushqimore”** janë rezultat fizik i prodhimit bujqësor, si dhe i operacioneve industriale për përpunimin e produkteve; Në produktet bujqësore dhe në produktet

ushqimore, në kuptim të këtij ligji përfshihen produktet nga Aneksi I i Marrëveshjes për funksionimin e Bashkimit Europian, si dhe produktet që nuk janë në Aneksin I, por që janë përfitur nga përpunimi i produkteve nga Aneksi I i Marrëveshjes për funksionimin e Bashkimit Europian;

2. **“Blerësi”** është çdo person fizik ose juridik ose organ publik që blen produkte bujqësore dhe ushqimore, respektivisht grup i këtyre personave fizikë dhe juridikë;

3. **“Organe publike”** janë ministritë, organet e administratës shtetërore, organizatat e përcaktuar me ligj, organet e tjera shtetërore, personat juridikë dhe fizikë të cilëve me ligj u është besuar të ushtrojnë autorizime publike, si dhe organet e komunës, Qytetit të Shkupit dhe komunave në Qytetin e Shkupit;

4. **“Furnizues”** është prodhuesi bujqësor ose çdo person fizik dhe juridik, i cili shet produkte bujqësore dhe ushqimore; termi “furnizues” mund të përfshijë një grup prodhuesish bujqësorë, respektivisht grup prodhuesish bujqësorë ose një grup personash fizikë dhe juridikë, siç janë organizatat e prodhuese, organizatat e furnizuese dhe shoqatat e këtyre organizatave;

5. **“Produktet bujqësore dhe ushqimore që prishen”** janë produkte bujqësore dhe ushqimore, të cilat për nga natyra e tyre ose në fazën e përpunimit mund të bëhen të papërshtatshme për shitje në afat prej 30 ditëve pas vjeljes, prodhimit ose përpunimit;

6. **“Praktikat e padrejta tregtare”** janë dispozita kontraktuale dhe praktika afariste që nga blerësi i imponohen në mënyrë të njëanshme furnizuesit në lidhje me shitjen e produkteve bujqësore dhe ushqimore, duke përdorur fuqinë e tij të konsiderueshme negociuese në raport me furnizuesin, në kundërshtim me nenet 7 dhe 8 të këtij ligji;

7. **“Të ardhurat e përgjithshme vjetore”** është shuma e të ardhurave nga shitja e produkteve dhe shërbimeve të shprehura në llogarinë vjetore dhe në raportin vjetor financiar, gjegjësisht bilancin e suksesit të blerësit dhe furnizuesit, të dorëzuar në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë së Veriut;

8. **“Zinxhiri i furnizimit të produkteve bujqësore dhe ushqimore”** janë të gjithë pjesëmarrësit në prodhimin, përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore dhe ushqimore, edhe atë: prodhuesit, blerësit dhe/ose përpunuesit, tregtarët me shumicë dhe tregtarët me pakicë, të cilët në marrëdhënie kontraktuale mund të jenë furnizues ose blerës, si dhe organet publike si blerës.

## **Lista e produkteve bujqësore dhe ushqimore**

### **Neni 5**

Ministri i Ekonomisë miraton listën e produkteve bujqësore dhe ushqimore, në bazë të së cilës përcaktohen praktikat e padrejta tregtare në zinxhirin e furnizimit të produkteve bujqësore dhe ushqimore.

## **KREU II**

### **FUQIA E KONSIDERUESHME NEGOCIUESE DHE PRAKTIKAT E PADREJTA TREGTARE**

#### **Fuqi e konsiderueshme negociuese**

### **Neni 6**

(1) Fuqi e konsiderueshme negociuese, respektivisht praktika të padrejta tregtare në pajtim me dispozitat e këtij ligji për shitjen e produkteve bujqësore dhe ushqimore, konsiderohet nëse:

1) furnizuesit kanë të ardhura vjetore jo më shumë se 2.000.000 euro në kundërvlerë denari, ndërsa blerësit kanë të ardhura vjetore jo më shumë se 10.000.000 euro në kundërvlerë denari;

2) furnizuesit kanë të ardhura vjetore më të mëdha se 2.000.000 euro në kundërvlerë denari dhe jo më të mëdha se 10.000.000 euro në kundërvlerë denari, ndërsa blerësit kanë të ardhura vjetore më të mëdha se 10.000.000 euro në kundërvlerë denari;

3) furnizuesit që kanë të ardhura vjetore mbi 10.000.000 euro në kundërvlerë denari dhe jo më shumë se 50.000.000 euro në kundërvlerë denari, ndërsa blerësit që kanë të ardhura vjetore mbi 50.000.000 euro në kundërvlerë denari;

4) furnizuesit që kanë të ardhura vjetore më të mëdha se 50.000.000 euro në kundërvlerë denari dhe jo më të mëdha se 150.000.000 euro në kundërvlerë denari, ndërsa blerësit kanë të ardhura vjetore më të mëdha se 150.000.000 euro në kundërvlerë denari;

5) furnizuesit që kanë të ardhura vjetore mbi 150.000.000 euro në kundërvlerë denari dhe jo më shumë se 350.000.000 euro në kundërvlerë denari, ndërsa blerësit kanë të ardhura vjetore mbi 350.000.000 euro në kundërvlerë denari;

(2) Me përjashtim të paragrafit (1) të këtij neni, dispozitat e këtij ligji zbatohen kur shitja e produkteve bujqësore dhe ushqimore bëhet nga furnizues që kanë të ardhura vjetore jo më të mëdha se 350.000.000 euro në kundërvlerë denari, për të gjithë blerësit që janë organe publike.

(3) Kur blerësi dhe furnizuesi sipas paragrafit (1) të këtij neni është shoqëri që ka pjesëmarrje të konsiderueshme në shoqëri tjetër, ose shoqëri që ka ndikim mbizotërues mbi shoqëri të varur prej saj në pajtim me Ligjin e Shoqërive Tregtare, gjatë përlllogaritjes së të ardhurave të saj të përgjithshme vjetore, blerësi, respektivisht furnizuesi, konsiderohet shoqëri tregtare.

(4) Gjatë përlllogaritjes së të ardhurave të përgjithshme të ndërmarrjeve sipas paragrafit (3) të këtij neni, nuk merren parasysh shumat e realizuara nga shitja e mallrave dhe dhënia e shërbimeve ndërmjet këtyre shoqërive.

### **Forma dhe përmbajtja e marrëveshjes për furnizimin e produkteve bujqësore dhe ushqimore dhe ndalimi i praktikës së padrejtë tregtare**

#### **Neni 7**

(1) Marrëveshja për furnizim me produkte bujqësore dhe ushqimore ndërmjet furnizuesit dhe blerësit duhet të lidhet me shkrim para dorëzimit të produkteve bujqësore ose ushqimore.

(2) Marrëveshja sipas paragrafit (1) të këtij neni duhet të përmbajë të gjitha kushtet e nevojshme për rregullimin e marrëdhënieve afariste ndërmjet furnizuesit dhe blerësit si palë kontraktuese, e në veçanti duhet të përmbajë dispozita për:

1) çmimin e produktit bujqësor dhe/ose ushqimor dhe mënyrën e përcaktimit ose përlllogaritjes së çmimit;

2) cilësinë dhe llojin e produktit bujqësor dhe ushqimor që do t'i dorëzohet blerësit;

3) termat dhe kushtet për dorëzimin e produkteve bujqësore dhe ushqimore që janë lëndë e marrëveshjes;

4) kushtet dhe afatet për pagesën e produkteve të dorëzuara bujqësore dhe ushqimore;

5) vendin e dorëzimit të produkteve bujqësore dhe ushqimore;

6) kohëzgjatjen e marrëveshjes dhe

7) dispozitat për ndërprerjen dhe anulimin e marrëveshjes.

(3) Përveç kushteve sipas paragrafit (2) të këtij neni, marrëveshja e furnizimit e përmendur në paragrafin (1) të këtij neni duhet të përcaktojë qartë dhe pa mëdyshje kushtet e përgjithshme afariste ndërmjet palëve kontraktuese, të cilat nuk mund të përmbajnë dispozita që konsiderohen praktika të padrejta tregtare në pajtim me nenin 8 të këtij ligji.

(4) Me kushtet e përgjithshme afariste sipas paragrafit (3) të këtij neni do të përcaktohen kushtet për shitje dhe blerje, të drejtat dhe detyrimet e furnizuesit dhe të drejtat dhe detyrimet e blerësit, sigurimin e kërkesave të furnizuesit, të drejtat dhe detyrimet e furnizuesit dhe blerësit në rastin kur blerësi do të ndërpresë kontratën, shkëmbimin e informacioneve, ndryshimin e

kushteve të përgjithshme, fuqinë mbinatyrore, zgjidhjen e kontesteve, mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetin.

(5) Kushtet e përgjithshme afariste nga paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni do të jenë detyruese për palët kontraktuese sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(6) Nëse marrëveshja e furnizimit nga pika (1) e këtij neni parashikon dorëzimin e rregullt të:

- produkte bujqësore dhe ushqimore që prishen lehtësisht, afatet dhe kushtet për pagesën e çdo dërgese sipas paragrafit (2) pika 4) e këtij neni nuk mund të jenë më vonë se 30 ditë pas përfundimit të periudhës së dakorduar të dorëzimit në të cilën është bërë ose më vonë se 30 ditë pas datës në të cilën përcaktohet vlera e urdhërpagesës ose faturës që do të paguhet për atë periudhë të dorëzimit, pavarësisht se cila nga këto dy data është më vonë.

- produkte të tjera bujqësore dhe ushqimore që nuk konsiderohet se prishen, kushtet dhe afatet për pagesën e çdo dorëzimi sipas paragrafit (2) pika 4) e këtij neni, nuk mund të jenë më vonë se 60 ditë pas përfundimit të periudhës së dakorduar të dorëzimit në të cilën është bërë ose më vonë se 60 ditë pas datës në të cilën përcaktohet shuma në urdhërpagesën ose faturën që do të paguhet për atë periudhë të dorëzimit, pavarësisht se cila nga këto dy data është më vonë.

(7) Për nevojat e përcaktimit të afateve të pagesës sipas paragrafit (6) të këtij neni, periudha e dakorduar e dorëzimit nuk do të tejkalojë në asnjë rast periudhën prej një muaji.

(8) Nëse marrëveshja nuk parashikon dorëzim të rregullt, afatet dhe kushtet për pagesën e produkteve bujqësore dhe ushqimore të dorëzuara që prishen, sipas paragrafit (2) pika 4) e këtij neni, nuk mund të jenë më vonë se afati i parashikuar në paragrafin (6) nënparagrafi 1) të këtij neni.

(9) Nëse marrëveshja nuk parashikon dorëzim të rregullt, kushtet dhe afatet për pagesën e produkteve të tjera bujqësore dhe ushqimore sipas paragrafit (2) pika 4) e këtij neni, që konsiderohen produkte që prishen, nuk mund të jenë më vonë se afati i parashikuar në paragrafit (6) nënparagrafi 2) të këtij neni.

(10) Me përjashtim të paragrafëve (6), (8) dhe (9) të këtij neni, kur blerësi përcakton shumën që do të paguhet, afatet e pagesës fillojnë të rrjedhin nga fundi i periudhës së dakorduar të dorëzimit mbi baza të rregullta dhe afatet e pagesës fillojnë të rrjedhin nga data e dërgesave të realizuara mbi baza të parregullta, që duhet të specifikohen në marrëveshjet për furnizimin e produkteve bujqësore dhe ushqimore.

(11) Dispozitat sipas paragrafëve (6), (7), (8), (9) dhe (10) të këtij neni në marrëveshjet për furnizimin e produkteve bujqësore dhe ushqimore nuk do të zbatohen për pagesat:

- nga blerësi drejt furnizuesit në kuadër të programe shkollore në institucionet arsimore (kopshte, institucione parashkollore dhe institucione të arsimit fillor dhe të mesëm) për furnizimin e produkteve nga sektori i frutave dhe perimeve dhe përpunimeve të tyre dhe qumështit dhe produkteve të qumështit që konsiderohen për ndihmë;

- nga organet publike që ushtrojnë mbrojtje shëndetësore drejt furnizuesve që i furnizojnë ata me produkte bujqësore dhe ushqimore dhe

- ndërmjet furnizuesve të rrushit ose mustave për prodhimin e verës dhe blerësve të tyre të drejtpërdrejtë, me kusht që kushtet specifike të pagesës të specifikohen në marrëveshjet për furnizim dhe të jenë me afat shumëvjeçar, në pajtim me praktikën e vendosura afariste.

(12) Për çdo gjë që nuk është rregulluar me këtë ligj në lidhje me marrëveshjet për furnizimin e produkteve bujqësore dhe ushqimore ndërmjet blerësit dhe furnizuesit, zbatohet Ligji i Marrëdhënieve të Detyrueshme.

### **Praktikat e ndaluara tregtare të padrejta**

Neni 8

(1) Pavarësisht nga fuqia negociuese në nenin 6 të këtij ligji, praktikat e padrejta tregtare në marrëdhëniet ndërmjet blerësit dhe furnizuesit do të konsiderohen të ndaluara, kur blerësi:

1. anulon porosinë e produkteve bujqësore dhe ushqimore që prishen brenda më pak se 30 ditëve nga data e porosisë, në mënyrë që furnizuesi të mos presë në mënyrë të arsyeshme të gjejë një mënyrë alternative për tregtimin ose përdorimin e këtyre produkteve;

2. ndryshon në mënyrë të njëanshme kushtet e marrëveshjes për furnizimin e produkteve bujqësore dhe ushqimore që janë të zakonshme në raport me mënyrën, vendin, kohën ose vëllimin e furnizimit ose dorëzimit të produkteve bujqësore dhe ushqimore, standardet e cilësisë, kushtet e pagesës ose çmimet për dhënie të shërbimeve;

3. kërkon pagesa nga furnizuesi që nuk kanë lidhje me shitjen e produkteve bujqësore dhe ushqimore tek furnizuesi;

4. kërkon pagesa nga furnizuesi për dëmin ose humbjen e shkaktuar, ose për të dyja, të produkteve bujqësore dhe ushqimore që janë vendosur në ambientet e blerësit ose pasi pronësia të është transferuar blerësit, dhe dëmi ose humbja e tillë nuk shkaktohet nga neglizhenca ose faji i furnizuesit, përveç nëse produkti ka një të metë të fshehur;

5. refuzon t'i konfirmojë me shkrim kushtet e marrëveshjes së furnizimit për të cilat furnizuesi ka kërkuar t'i konfirmojë me shkrim, përveç rasteve kur marrëveshja për furnizimin e produkteve bujqësore dhe ushqimore mbulon produktet e paraqitura nga një anëtar i një organizate prodhuese dhe kooperative, në organizatën prodhuese të së cilës furnizuesi është anëtar, nëse dispozitat në statutet e tyre kanë efekte të ngjashme me kushtet e marrëveshjes për furnizimin e produkteve bujqësore dhe ushqimore;

6. përvetëson, përdor ose zbulon në mënyrë të paligjshme sekretet afariste të furnizuesit;

7. kërcënon furnizuesin se do të kryejë veprime hakmarrjeje tregtare nëse furnizuesi shfrytëzon të drejtat e tij kontraktuale dhe ligjore, duke përfshirë parashtrimin e kërkesës në Komisionin e mbrojtjes së konkurrencës për të filluar procedurë ose parashtrësë ose do të bashkëpunojë me Komisionin e mbrojtjes së konkurrencës gjatë procedurës;

8. kërkon kompensim nga furnizuesi për kostot e zbatimit të hetimeve ndaj ankesave të parashtruara të konsumatorëve në lidhje me shitjen e produkteve të furnizuesit, edhe pse furnizuesi nuk ka faj ose gabim;

9. kërkon kompensim nga furnizuesi për vendosjen e një produkti të ri bujqësor dhe ushqimor në rrjetin e shitjeve dhe për zgjerimin e rrjetit të shitjeve të blerësit, rregullimin dhe rimodelimin e pikave ekzistuese të shitjes së blerësit, zgjerimin e kapacitetit të magazinimit të blerësit dhe zgjerimin e rrjetit të shpërndarjes së blerësit;

10. kërkon që furnizuesi të bjerë dakord për shërbime fiktive që nuk do të kryhen, për të cilat nuk ka arsye tjetër përveç shtyrjes së afatit tashmë të caktuar për pagesë;

11. kërkon kompensim nga furnizuesi për lidhjen e marrëveshjes për furnizimin e produkteve bujqësore dhe ushqimore;

12. kushtëzon furnizuesin që të lidhë marrëveshje dhe bashkëpunime afariste për kompensimin e produkteve dhe shërbimeve bujqësore dhe ushqimore;

13. kërkon nga furnizuesi të mos ua shesë produktet bujqësore dhe ushqimore blerësve të tjerë me çmime më të ulëta se ato që janë dakorduar të paguhen nga blerësi, ndërsa furnizuesi nuk duhet t'i kërkojë blerësit të blejë produkte që nuk i kërkon;

14. kërkon kompensim nga furnizuesi për të ardhurat e reduktuara të blerësit për shkak të shitjeve të reduktuara ose marzhit të produktit të caktuar bujqësor ose ushqimor;

15. kërkon kompensim nga furnizuesi për dorëzimin e produkteve bujqësore dhe ushqimore në vendin e dorëzimit ose jashtë vendit të dakorduar të dorëzimit, me përjashtim të rasteve kur blerësi kryen shpërndarjen e vet me mjetet dhe burimet e veta në vend të furnizuesit;

16. kërkon kompensim nga furnizuesi për humbimin e tregut, në lidhje me ofertën dhe kërkesën e produkteve të caktuara bujqësore dhe ushqimore;

17. fshin në mënyrë të njëanshme produktet nga lista e produkteve të dakorduara që furnizuesi ia dorëzon blerësit ose zvogëlon ndjeshëm porosinë e produkteve individuale bujqësore dhe ushqimore pa njoftim paraprak me shkrim për furnizuesin në një periudhë jo më të shkurtër se 30 ditë;

18. arkëton shpenzime nga furnizuesi për analiza shtesë të cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore, përveç rasteve kur analizat shtesë përcaktojnë se produkti i furnizuesit nuk përmbush cilësinë e dakorduar, me ç'rast kostot e analizave shtesë nuk duhet të jenë më të larta se kostot që ka pasur blerësi;

19. kërkon kompensim nga furnizuesi për shërbimet që nuk janë dhënë;

20. kthen tek furnizuesi produktet bujqësore dhe ushqimore të pashitura që janë dorëzuar pa i paguar ose pa paguar për heqjen e këtyre produkteve;

21. kërkon kompensim nga furnizuesi për magazinimin, paraqitjen ose vendosjen e produkteve bujqësore dhe ushqimore në raftet në pikën e shitjes së blerësit;

22. kërkon që furnizuesi të përballojë plotësisht ose pjesërisht kostot e zbritjeve për produktet bujqësore dhe ushqimore të shitura si pjesë e promovimit;

23. kërkon që furnizuesi të paguajë për reklamimin e produkteve bujqësore dhe ushqimore që ai i reklamoi;

24. kërkon që furnizuesi të paguajë për tregtimin e produkteve bujqësore dhe ushqimore që ai i zbaton;

25. kërkon kompensim nga furnizuesi për personelin për pajisjen e ambienteve në të cilat kryhet shitja e produkteve bujqësore dhe ushqimore tek furnizuesi;

26. kërkon kompensime dhe pagesa të tjera të vendosura ndaj furnizuesit gjatë lidhjes së marrëveshjeve për furnizimin e produkteve bujqësore dhe ushqimore.

(2) Pavarësisht sipas paragrafit (1) pika 22) e këtij neni, nuk do të konsiderohet praktikë e padrejtë tregtare kur furnizuesi i kërkon blerësit me shkrim në një mënyrë të qartë dhe pa mëdyshje të bjerë dakord për periudhën e promovimit (promovimit, aksionit dhe shitjeve sezonale) dhe sasinë e produkteve bujqësore dhe ushqimore që do të porositen nga furnizuesi me një çmim të ulur.

(3) Në rastin sipas paragrafit (2) të këtij neni, me kërkesë të furnizuesit, blerësi ka detyrim shtesë për t'i siguruar furnizuesit të dhëna për sasinë e shitura me çmim të zbritur, pas përfundimit të periudhës së promovimit.

(4) Nëse furnizuesi me kërkesë të blerësit ka dorëzuar sasi më të madhe se sasia e shitur konsumatorëve gjatë promovimit, blerësi duhet t'i paguajë furnizuesit diferencën e sasisë së dorëzuar dhe të shitur me çmim të rregullt.

(5) Me përjashtim të paragrafit (1) pikat 21), 23), 24) dhe 25) të këtij neni, nuk do të konsiderohet praktikë e ndaluar e padrejtë tregtare kur furnizuesi detyrimisht do t'i kërkojë blerësit, në mënyrë të qartë dhe pa mëdyshje, me shkrim brenda kornizës së marrëveshjes së furnizimit, të paraqesë vlerësim objektiv dhe të arsyeshëm të kostove dhe pagesës për njësi, ose pagesës së përgjithshme, sipas një liste të përcaktuar çmimesh të Blerësit.

(6) Me përjashtim të paragrafit (5) të këtij neni dhe zbritjet që furnizuesi do t'ia aprovojë blerësit nuk duhet të jenë më të larta se 10% e qarkullimit të realizuar në vitin rrjedhës, e që duhet të përfshihen qartë në marrëveshjet për furnizimin e produkteve bujqësore dhe ushqimore.

### KREU III

## ORGANI KOMPETENT DHE PROCEDURA E KUNDËRVAJTJES

### Neni 9

- 1) Komisioni i mbrojtjes së konkurrencës mbikëqyr zbatimin e dispozitave të këtij ligji.
- 2) Komisioni i mbrojtjes së konkurrencës kontrollon zbatimin e dispozitave të këtij ligji.

3) Për shkeljet e përcaktuara nga ky ligj, organi kompetent për kundërvajtje është Komisioni i mbrojtjes së konkurrencës.

### **Kompetencë për kundërvajtje**

#### **Neni 10**

Për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë ligj, procedurë për kundërvajtje para Komisionit të mbrojtjes së konkurrencës udhëheqë dhe sanksion për kundërvajtje shqipton Komisioni për vendimmarrje ndaj kundërvajtjes.

### **Zbatimi i ligjit**

#### **Neni 11**

Komisioni i mbrojtjes së konkurrencës për vendimmarrje ndaj kundërvajtjes dhe gjatë udhëheqjes së procedurës për kundërvajtje i zbaton në mënyrë përkatëse dispozitat e Ligjit të Mbrojtjes së Konkurrencës dhe Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative, përveç nëse përcaktohet ndryshe me Ligjin e Kundërvajtjes dhe me këtë ligj.

### **Nisja e procedurës për kundërvajtje**

#### **Neni 12**

(1) Procedurat për kundërvajtje para Komisionit të vendimmarrjes ndaj kundërvajtjes do të fillojnë sipas detyrës zyrtare me kërkesë të një personi fizik ose juridik që ka interes legjitim për të përcaktuar ekzistimin e kundërvajtjes.

(2) Komisioni i vendimmarrjes ndaj kundërvajtjes fillon procedimin e kundërvajtjes me konkluzion, kundër të cilit nuk lejohet ankesë, as padi për fillimin e kontestit administrativ.

(3) Konkluzioni për fillimin e procedurës duhet të përmbajë:

- 1) numrin e lëndës me të cilin lidhet konkluzioni;
- 2) dispozitat e ligjit në bazë të të cilit fillon procedura;

3) përshkrim i fakteve dhe rrethanave për shkak të të cilave Komisioni i vendimmarrjes fillon procedurë ndaj kundërvajtjes;

4) kërkesë për dorëzimin e të dhënave të nevojshme, në pajtim me nenin 18 të këtij ligji.

(4) Konkluzioni për fillimin e procedurës do t'i dorëzohet personit kundër të cilit është filluar procedura dhe parashtruesit të kërkesës, nëse procedura është filluar me kërkesë të një personi fizik ose juridik që ka interes legjitim për të përcaktuar ekzistimin e kundërvajtjes.

(5) Personi ndaj të cilit ka filluar procedura ka të drejtë të japë përgjigje në afat prej tetë ditëve nga dita e pranimit të konkluzionit për fillimin e procedurës. Me përjashtim, ndaj kërkesës së personit ndaj të cilit ka filluar procedura, afati mund t'i vazhdohet edhe më së shumti 15 ditë, nëse ka arsye të justifikuara për këtë.

(6) Procedura e kundërvajtjes e filluar para Komisionit të vendimmarrjes ndaj kundërvajtjes do të përfundojë në afat prej tre muajve.

### **Përmbajtja e kërkesës për nisjen e procedurës për kundërvajtje me kërkesë të personit fizik ose juridik**

#### **Neni 13**

(1) Kërkesa për nisjen e procedurës për kundërvajtje me kërkesë të një personi fizik ose juridik që ka interes legjitim për të përcaktuar ekzistimin e kundërvajtjes duhet të përfshijë:

1) ndërmarrjen dhe selinë e regjistruar të personit juridik, respektivisht emri, mbiemri dhe adresa e personit fizik - parashtrues i kërkesës dhe përshkrimin e rrethanave nga të cilat ka rezultuar interesi legjitim për parashtrimin e kërkesës;

2) të dhëna për personin kundër të cilit është parashtruar kërkesa;

3) përshkrim faktik të veprës nga e cila rezultojnë tiparet juridike të kundërvajtjes, kohën, vendin dhe mënyrën e ekzekutimit dhe rrethana të tjera të nevojshme për përcaktimin sa më të afërt të kundërvajtjes;

4) provat që do të paraqiten;

5) nënshkrimi i parashtruesit të kërkesës.

(2) Bashkë me kërkesën sipas paragrafit (1) të këtij neni dorëzohen edhe prova.

(3) Nëse kërkesa sipas paragrafit (1) të këtij neni përmban të dhëna që, sipas parashtruesit të kërkesës, përbëjnë sekret afarist, ai është i detyruar t'i shënojë qartë këto të dhëna dhe të përcaktojë bazën juridike për shënimin e tyre si sekret afarist.

(4) Gjatë parashtrimit të kërkesës për nisjen e procedurës për kundërvajtje që përmban të dhëna që përbëjnë sekret afarist, zbatohen në mënyrë përkatëse dispozitat e nenit 18 paragrafi (4), (5) dhe (6) të këtij ligji.

(5) Nëse parashtruesi i kërkesës sipas paragrafit (1) të këtij neni dëshiron të mbetet anonim ose është parashtruar kërkesë që nuk përmban të dhëna për parashtruesin, Komisioni për vendimmarrje ndaj kundërvajtjes nisë procedurë sipas detyrës zyrtare, nëse përcakton se ekzistojnë praktikë e padrejtë e mundshme tregtare në zinxhirin e furnizimit të produkteve bujqësore dhe ushqimore.

### **Plotësimi i kërkesës për nisjen e procedurës kundërvajtëse të parashtruar nga person fizik ose juridik**

#### **Neni 14**

(1) Nëse kërkesa për nisjen e procedurës për kundërvajtje nuk përmban të dhënat nga neni 13 i këtij ligji, Komisioni i vendimmarrjes ndaj kundërvajtjes nga parashtruesi i kërkesës do të kërkojë plotësimin e kërkesës.

(2) Nëse parashtruesi i kërkesës nuk vepron në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit së kërkesës për plotësim, do të konsiderohet se ai ka hequr dorë nga kërkesa.

### **Anulimi i kërkesës për nisjen e procedurës kundërvajtëse të parashtruar nga person fizik ose juridik**

#### **Neni 15**

(1) Nëse procedura nisët me kërkesë të personit fizik ose juridik, ai mund të heqë dorë nga kërkesa gjatë gjithë procedurës.

(2) Kur procedura nisët me kërkesë të një personi fizik ose juridik dhe ky i fundit heq dorë nga kërkesa, Komisioni i vendimmarrjes ndaj kundërvajtjes miraton konkluzion për ndërprerjen e procedurës.

(3) Komisioni i vendimmarrjes ndaj kundërvajtjes do të vazhdojë udhëheqjen e procedurës sipas paragrafit (1) të këtij neni sipas detyrës zyrtare, nëse ka tregues të praktikave të padrejta tregtare në zinxhirin e furnizimit të produkteve bujqësore dhe ushqimore.

(4) Kur nis procedura sipas detyrës zyrtare, Komisioni për vendimmarrje ndaj kundërvajtjes me konkluzion mund të ndërpresë procedurën.

(5) Kundër konkluzionit për ndërprerje të procedurës sipas paragrafit (2) dhe (4) të këtij neni, mund të parashtrohet ankesë për nisjen e kontestit administrativ në gjykatën kompetente për

vendimmarrje ndaj kontestit administrativ në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të konkluzionit.

### **Refuzimi i kërkesës për nisjen e procedurës kundërvajtëse të parashtruar nga një person fizik ose juridik**

#### Neni 16

(1) Nëse Komisioni i vendimmarrjes ndaj kundërvajtjes konstaton se nuk ka kushte ligjore për nisjen e procedurës, kërkesa nga neni 13 i këtij ligji refuzohet me konkluzion.

(2) Nuk ka kushte ligjore për nisjen e procedurës nëse:

- 1) veprimi i përshkruar në kërkesë nuk është kundërvajtje;
- 2) kërkesa është parashtruar nga një person që nuk ka interes legjitim për të përcaktuar kundërvajtje;
- 3) kërkesa nuk mbështetet me dëshmi;
- 4) ka ndodhur vjetrimi për nisjen e procedurës për kundërvajtje në pajtim me nenin 29 të këtij ligji.

(3) Kundër konkluzionit për ndërprerje të procedurës sipas paragrafit (1) të këtij neni, mund të parashtrohet ankesë për nisjen e kontestit administrativ në gjykatën kompetente për vendimmarrje ndaj kontestit administrative në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të konkluzionit.

(4) Konkluzioni sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk duhet të përmbajë domosdoshmërisht vlerësim të çdo gjetjeje në kërkesën për fillimin e procedurës, por duhet të përmbajë arsye të shprehura qartë për refuzimin e kërkesës.

### **Pjesëmarrësit në procedurat e kundërvajtjes**

#### Neni 17

Pjesëmarrësit në procedurat e kundërvajtjes janë:

- personi kundër të cilit ka filluar procedura për kundërvajtje dhe
- parashtruesi i kërkesës për fillimin e procedurës për kundërvajtje nga neni 13 i këtij ligji.

## **KREU IV PROCEDURA E PROVËS**

### **Kërkesa për të dhënat**

#### Neni 18

(1) Me qëllim të ushtrimit të kompetencave të përcaktuara nga ky ligj, Komisioni për vendimmarrje ndaj kundërvajtjes mund t'i kërkojë blerësit dhe furnizuesit të paraqesin të dhëna në lidhje me gjendjen e tyre ekonomike financiare, marrëdhëniet e tyre afariste dhe lidhjet, të dhënat për statutet dhe vendimet e tyre, për numrin dhe identitetin e personave të prekur nga këto vendime, si dhe të dhënat tjera të nevojshme për udhëheqjen e procedurës.

(2) Konkluzioni për kërkesën për të dhëna duhet të përmbajë bazë juridike, qëllim të kërkesës, tregues të saktë të të dhënave të kërkuara, afat për dorëzimin e të dhënave të kërkuara, si dhe faktin se mosdhënia e të dhënave brenda afatit të kërkuar, dorëzimi i të dhënave të pasakta, të paplota ose të dhëna që mund të mashtrojnë Komisionin për vendimmarrje ndaj kundërvajtjes, është kundërvajtje, në pajtim me nenin 27 të këtij ligji.

(3) Kundër konkluzionit sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk lejohet ankesë ose padi për nisjen e kontestit administrativ.

(4) Nëse disa nga të dhënat sipas paragrafit (1) të këtij neni përbëjnë sekret afarist, ndërmarrjet janë të detyruara t'i shënojnë ato në mënyrë të qartë dhe të caktojnë bazën juridike për përcaktimin e tyre si sekret afarist.

(5) Gjatë dorëzimit të të dhënave që përbëjnë sekret afarist, ndërmarrjet sipas paragrafit (1) të këtij neni janë të detyruara t'ia dorëzojnë Komisionit të vendimmarrjes ndaj kundërvajtjes një kopje me të dhëna të përfshira që përbëjnë sekret afarist (versioni konfidencial) dhe kopje në të cilën do të fshihen të dhënat që përbëjnë sekret afarist (versioni jokonfidencial).

(6) Nëse blerësi dhe furnizuesi nuk veprojnë në pajtim me paragrafin (5) të këtij neni dhe dorëzojnë vetëm një version konfidencial të të dhënave të kërkuara, duke shënuar të dhënat që përbëjnë sekret afaristi, Komisioni kërkon dorëzimin e versionit jokonfidencial të të dhënave të kërkuara, në afat prej 3 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës. Nëse ndërmarrjet nuk dorëzojnë version jokonfidencial të të dhënave të kërkuara brenda kësaj periudhe, Komisioni për vendimmarrje ndaj kundërvajtjes vlerëson se të dhënat e dorëzuara nuk përmbajnë të dhëna që paraqesin sekret afarist.

### **Marrja e provave në vendin e ngjarjes**

#### **Neni 19**

(1) Nëse ekziston dyshimi i justifikuar se një blerës ose furnizues i caktuar mban dokumente ose sende të tjera ose ka njohuri që mund të jenë të rëndësishme për të provuar ekzistencën e kundërvajtjes, Komisioni për vendimmarrje ndaj kundërvajtjes, me konkluzion, mund t'i imponojë atij blerësi ose furnizuesit, personave të autorizuar nga Komisioni i mbrojtjes së konkurrencës dhe personave që, nëse është e nevojshme, i shoqërojnë ata:

1) t'i lejojë ata të hyjnë pa probleme në çdo hapësirë afariste, tokë ose automjet transporti të ndërmarrjes sipas paragrafit (1) të këtij neni, të cilat janë të rëndësishme për të përcaktuar ekzistencën e kundërvajtjes;

2) t'u mundësojë atyre të shqyrtojnë pa probleme librat ose dokumentacionin tjetër që janë të rëndësishme për vërtetimin e ekzistencës së kundërvajtjes, pavarësisht nga media në të cilin ruhet;

3) t'u mundësohet të marrin pa probleme ose të mbajnë në çdo formë kopje ose ekstrakte të atyre librave ose dokumentacionit;

4) t'i lejojë ata të marrin dhe të mbajnë pa probleme, përkohësisht, librat ose dokumentacionin tjetër që janë të rëndësishme për të vërtetuar ekzistencën e kundërvajtjes, për periudhën e nevojshme për kopjimin e tyre, nëse kopjimi i tyre nuk mund të bëhet në vendin e ngjarjes. Për këtë sekuestrim dhe mbajtje, personat e autorizuar të Komisionit të mbrojtjes së konkurrencës lëshojnë vërtetim me shkrim ku përshkruhen librat e sekuestruar dhe dokumentacioni tjetër dhe ku janë gjetur ato;

5) t'u lejohet marrja dhe mbajtja e përkohshme e sendeve, librave ose dokumentacionit tjetër që janë të rëndësishme për përcaktimin e ekzistencës së kundërvajtjes për periudhën e nevojshme për përcaktimin e fakteve dhe provave përkatëse që rrjedhin nga ato sende, libra dhe dokumentacion, por jo më gjatë se përfundimi i vlefshmërisë së procedurës në fjalë. Për këtë sekuestrim dhe mbajtje, personat e autorizuar të Komisionit të mbrojtjes së konkurrencës lëshojnë vërtetim me shkrim ku përshkruhen sendet, librat dhe dokumentacioni tjetër i sekuestruar dhe ku janë gjetur ato;

6) t'u lejojë atyre të mbyllin pa probleme hapësirat afariste dhe librat ose dokumentacionin tjetër për një periudhë dhe në masën e nevojshme për inspektim, por jo më shumë se shtatë ditë;

7) një person i autorizuar ose një punonjës tjetër i ndërmarrjes për t'i dhënë në procesverbal sqarim të fakteve ose dokumenteve që janë të rëndësishme për vërtetimin e ekzistencës së kundërvajtjes;

8) një person të autorizuar ose një punonjës tjetër të blerësit, respektivisht furnizuesit, për të dhënë sqarim me shkrim të fakteve ose dokumenteve që janë të rëndësishme për të vërtetuar ekzistencën e kundërvajtjes brenda një periudhe të caktuar kohore; dhe

9) t'u mundësojë atyre ushtrimin e papenguar të veprimeve të tjera që janë të rëndësishme për përcaktimin e ekzistencës së kundërvajtjes.

(2) Konkluzioni sipas paragrafit (1) të këtij neni përmban bazën juridike, lëndën dhe qëllimin e veprimit, emrin dhe mbiemrin e personave të autorizuar nga Komisioni i mbrojtjes së konkurrencës të cilët do të ushtrinë veprimet e përmendura në paragrafin (1) të këtij neni, kohën dhe vendin e ushtrimit të veprimeve sipas paragrafit (1) të këtij neni, si dhe faktin se pamundësimi i personave të autorizuar të Komisionit të mbrojtjes së konkurrencës për të kryer veprimet sipas paragrafit (1) të këtij neni paraqet kundërvajtje, në pajtim me nenin 27 të këtij ligji.

(3) Kundër konkluzionit sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk lejohet ankesë ose padi për fillimin e kontestit administrativ.

(4) Nëse disa nga të dhënat dhe dokumentacioni sipas paragrafit (1) të këtij neni, të marra ose të mbajtura nga personat e autorizuar të Komisionit të mbrojtjes së konkurrencës, përbëjnë sekret afarist ose zyrtar, personat juridikë dhe fizikë sipas paragrafit (1) të këtij neni, në afat prej 8 ditëve nga dita e ekzekutimit të veprimeve sipas paragrafit (1) të këtij neni, mund të inspektojnë të dhënat dhe dokumentacionin e marrë ose të mbajtur, të shënojnë qartë të dhënat dhe dokumentacionin që përbëjnë sekret afarit dhe të shënojnë bazën juridike për shënimin e tyre si të tilla.

(5) Nëse blerësi, respektivisht furnizuesi i përmendur në pikën (1) të këtij neni, nuk vepron në pajtim me paragrafin (4) të këtij neni, do të konsiderohet se të dhënat dhe dokumentacioni i marrë nuk përmbajnë të dhëna që përbëjnë sekret afarist.

(6) Gjatë ushtrimit të veprimeve sipas paragrafit (1) të këtij neni, personat e autorizuar të Komisionit mbajnë procesverbal të veprimeve të ndërmarra.

(7) Nëse gjatë ushtrimit të veprimeve sipas paragrafit (1) të këtij neni, ekziston rreziku i fshehjes, ndryshimit ose shkatërrimit të dokumenteve ose sendeve që mund të jenë të rëndësishme për vërtetimin e ekzistencës së kundërvajtjes, gjatë ushtrimit të veprimeve sipas paragrafit (1) të këtij neni, Komisioni i mbrojtjes së konkurrencës kërkon ndihmën e organit të administratës shtetërore përgjegjëse për ushtrimin e punëve të rendit dhe qetësisë publike.

(8) Nëse personi juridik dhe fizik sipas paragrafit (1) të këtij neni nuk i lejon personat e autorizuar të Komisionit të mbrojtjes së konkurrencës të ushtrinë veprimet sipas paragrafit (1) të këtij neni, personat e autorizuar të Komisionit të mbrojtjes së konkurrencës ushtrinë veprimet e nevojshme kundër vullnetit të personit juridik dhe fizik sipas paragrafit (1) të këtij neni, dhe me ndihmën e përfaqësuesve të organit të administratës shtetërore përgjegjëse për ushtrimin e punëve të rendit dhe paqes publike.

## **Masat e përkohshme**

### **Neni 20**

(1) Në raste urgjente, kur ekziston rreziku i shkakimit të dëmeve serioze dhe të riparueshme ndaj furnizuesit, Komisioni i vendimmarrjes ndaj kundërvajtjes mund të vendosë sipas detyrës zyrtare, me aktvendim, e në bazë të njohurive të tij fillestare për ekzistencën e kundërvajtjes, të vendosë një masë të përkohshme ndaj blerësit, i cili, me sjelljen e tij, mund t'i shkaktojë furnizuesit dëme të rënda dhe të riparueshme.

(2) Në vendimin sipas paragrafit (1) të këtij neni, Komisioni për vendimmarrje ndaj kundërvajtjes do të urdhërojë pezullimin e veprimeve të caktuara, përmbushjen e kushteve të caktuara ose masave të tjera të nevojshme për të parandaluar praktikatat e padrejta tregtare dhe do

të përcaktojë kohëzgjatjen e masave, të cilat do të jenë proporcionale dhe adekuate me qëllimin që do të arrihet nga masat e vendosura të përkohshme.

(3) Nëse është e nevojshme dhe e përshtatshme për të parandaluar praktikën e padrejta tregtare, Komisioni për vendimmarrje ndaj kundërvajtjes, me aktvendim, mund të ndryshojë masat e vendosura tashmë të përmendura në paragrafin (2) të këtij neni dhe/ose të ndryshojë kohëzgjatjen e tyre.

### **Njoftime për gjendjen e përcaktuar faktike**

#### **Neni 21**

(1) Për t'u dhënë pjesëmarrësve në procedurë mundësinë për të deklaruar faktet dhe rrethanat me rëndësi për përcaktimin e situatës faktike, Komisioni për vendimmarrje ndaj kundërvajtjes, përpara caktimit të debatit me gojë, do t'u ofrojë pjesëmarrësve njoftim për gjendjen e përcaktuar faktike deri atëherë.

(2) Pjesëmarrësit në procedurë kanë të drejtë të deklarojnë me shkrim pretendimet e përfshira në njoftimin sipas paragrafit (1) të këtij neni, të bëjnë vërejtje dhe të propozojnë paraqitjen e provave në dispozicion të tyre, të cilat sipas tyre janë të rëndësishme për përcaktimin e saktë të gjendjes faktike, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të njoftimit.

### **Marrja përsipër e detyrimeve**

#### **Neni 22**

(1) Pas fillimit të procedurës nga neni 12 i këtij ligji, personi ndaj të cilit është nisur procedura mund, në afat prej 60 ditëve nga dita e pranimit të konkluzionit për fillimin e procedurës së kundërvajtjes, t'i ofrojë Komisionit propozim për marrjen përsipër të detyrimeve në formën e ekzekutimit të masave dhe kushteve të caktuara si dhe afateve në kuadër të të cilave do t'i përmbushë ato, me qëllim heqjen e indikacioneve që tregojnë praktika të padrejta tregtare dhe që kanë qenë arsyeja e nisjes së procedurës së kundërvajtjes.

(2) Komisioni i vendimmarrjes ndaj kundërvajtjes, në varësi të peshës së shkeljes, fushëveprimit të shkeljes dhe kohëzgjatjes së shkeljes, të cilat përcaktohen në procedurën e kundërvajtjes, do të vlerësojë nëse masat, kushtet dhe afatet e propozuara në paragrafin (1) të këtij neni, janë të mjaftueshme për të hequr indikacionet që tregojnë praktika të padrejta tregtare dhe që kanë qenë arsyeja e nisjes së procedurës së kundërvajtjes. Nëse Komisioni për vendimmarrje ndaj kundërvajtjes konsideron se ato janë të mjaftueshme, ai do të pranojë me konkluzion detyrimet e ofruara sipas paragrafit (1) të këtij neni. Konkluzioni me të cilin pranohen detyrimet e ofruara përmban përkrahje të detyrimeve, kushteve dhe afateve brenda të cilave ato duhet të përmbushen dhe detyrim të personit ndaj të cilit janë filluar procedurat për të siguruar prova se detyrimet janë përmbushur. Kundër këtij konkluzioni nuk lejohet ankesë ose padi për fillimin e kontestit administrativ.

(3) Procedura para Komisionit të vendimmarrjes ndaj kundërvajtjes pezullohet deri në përfundimin e afatit të përcaktuar në konkluzionin sipas paragrafit (2) të këtij neni. Nëse pas skadimit të këtij afati nuk dorëzohet prova se detyrimet janë përmbushur, do të vazhdojë procedura përpara Komisionit të vendimmarrjes ndaj kundërvajtjes.

(4) Nëse Komisioni i vendimmarrjes ndaj kundërvajtjes konstaton se nuk ka kushte ligjore për udhëheqjen e procedurës për shkak të përmbushjes së detyrimeve të marra përsipër sipas paragrafit (1) të këtij neni, ndërpret procedurën me konkluzion ndaj të cilit mund të ngrihet padi për fillimin e kontestit administrativ në gjykatën kompetente në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të konkluzionit.

(5) Komisioni i vendimmarrjes ndaj kundërvajtjes nuk do të pranojë detyrimet, masat, kushtet dhe afatet e ofruara sipas paragrafit (1) të këtij neni, nëse përcakton se ato nuk janë të mjaftueshme për të hequr indikacionet që tregojnë praktika të padrejta tregtare dhe që kanë qenë arsyeja për nisjen e procedurës kundërvajtëse. Kundër këtij konkluzioni nuk lejohet ankesë ose padi për nisjen e kontestit administrativ.

### **Debati gojor**

#### **Neni 23**

(1) Komisioni i vendimmarrjes ndaj kundërvajtjes do të përcaktojë mbajtjen e debatit gojor nëse kjo është e nevojshme për të përcaktuar gjendjen faktike.

(2) Personi ndaj të cilit është nisur procedura dhe parashtruesi i kërkesës për nisjen e procedurës thirren në debatin gojor, nëse procedura është nisur me kërkesë të personit juridik ose fizik.

(3) Përveç personave sipas paragrafit (2) të këtij neni, në debat mund të thirren edhe persona të tjerë.

### **Aktvendimet e Komisionit të vendimmarrjes ndaj kundërvajtjes**

#### **Neni 24**

(1) Pasi Komisioni i vendimmarrjes ndaj kundërvajtjes do të përcaktojë plotësisht gjendjen faktike me rëndësi për vendimmarrjen e drejtë, miraton:

1) aktvendim me të cilin konstaton se personi ndaj të cilit është nisur procedura ka kryer kundërvajtje të parashikuar nga dispozitat e këtij ligji dhe ka vendosur sanksionin e duhur për kundërvajtje ose

2) aktvendim me të cilin përcakton se personi ndaj të cilit është nisur procedura nuk ka kryer vepër penale të parashikuar nga dispozitat e këtij ligji.

(2) Aktvendimet e përmendura në paragrafin (1) të këtij neni miratohen nga Komisioni i vendimmarrjes ndaj kundërvajtjes në afat prej 60 ditëve nga dita e paraqitjes së njoftimit për gjendjen faktike të përcaktuar të përmendur në nenin 21 të këtij ligji.

### **Mbrojtja gjyqësore në procedurë kundërvajtëse**

#### **Neni 25**

(1) Aktvendimet e Komisionit të vendimmarrjes ndaj kundërvajtjes janë përfundimtare. Kundër këtyre aktvendimeve mund të ngrihet padi për nisjen e kontestit administrativ përpara gjykatës kompetente.

(2) Padia për nisjen e kontestit administrativ sipas paragrafit (1) të këtij neni parashtrohet në afat prej 30 ditëve nga pranimi i aktvendimit dhe kjo do ta shtyjë ekzekutimin e aktvendimit.

## **KREU V DISPOZITAT KUNDËRVAJTËSE**

### **Kundërvajtjet më të rënda**

#### **Neni 26**

(1) Gjobë në vlerë prej 1.000 deri 2.000 euro në kundërvlerë denari për mikrotregtar, gjobë në vlerë prej 2.000 deri 4.000 euro në kundërvlerë denari për tregtar të vogël, gjobë në vlerë prej

6.000 deri 12.000 euro në kundërvlerë denari për tregtar të mesëm dhe gjobë në vlerë prej 10.000 deri 20.000 euro në kundërvlerë denari për tregtar të madh, do t'i shqiptohen personit juridik që në cilësinë e blerësit përdor fuqi të konsiderueshme negociuese kundër furnizuesve të tij duke imponuar praktika të padrejta tregtare, nëse:

1) marrëveshja e furnizimit në mënyrë të qartë dhe pa mëdyshje nuk përcakton termat dhe kushtet e përgjithshme të biznesit ndërmjet palëve kontraktuese në pajtim me nenin 7 paragrafët (3), (4) dhe (5) të këtij ligji;

2) nuk respekton afatet dhe kushtet e pagesës në pajtim me nenin 7 paragrafët 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11 të këtij ligji;

3) vepron në kundërshtim me çdo ndalim të praktikave të padrejta tregtare, të përmendura në nenin 8 paragrafi (1) i këtij ligji;

4) nuk zbaton detyrimin sipas nenit 8 paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij ligji;

5) nuk zbaton detyrimin sipas nenit 8 paragrafi (5) të këtij ligji;

6) vepron në kundërshtim me nenin 8 paragrafi (6) i këtij ligji.

(2) Gjobë në vlerë prej 50 deri 100 euro në kundërvlerë denari për mikro tregtar, gjobë në vlerë prej 100 deri 200 euro në kundërvlerë denari për tregtar të vogël, gjobë në vlerë prej 200 deri 350 euro në kundërvlerë denari për tregtar të mesëm dhe gjobë në vlerë prej 350 deri 500 euro në kundërvlerë denari për tregtar të madh, do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për veprimet sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(3) Gjobë në vlerë prej 300 deri 500 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje tregtarit individual për veprimet sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(4) Gjobë në vlerë prej 300 deri 500 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik për veprimet sipas paragrafit (1) të këtij neni.

### **Kundërvajtjet më të lehta**

#### **Neni 27**

(1) Gjobë në vlerë prej 500 deri 750 euro në kundërvlerë denari për mikro tregtar, gjobë në vlerë prej 1.000 deri 1.500 euro në kundërvlerë denari për tregtar të vogël, gjobë në vlerë prej 3.000 deri 4.000 euro në kundërvlerë denari për tregtar të mesëm dhe gjobë në vlerë prej 5.000 deri 6.000 euro në kundërvlerë denari për tregtar të madh do t'i shqiptohen për kundërvajtje personit juridik nëse:

1) nuk vepron ndaj konkluzionit të Komisionit të vendimmarrjes ndaj kundërvajtjes për dhënie e të dhënave në afatin e përcaktuar në pajtim me nenin 18 paragrafi (2) të këtij ligji;

2) dorëzon të dhëna të pasakta, të paplota ose që mund të mashtrojnë Komisionin për vendimmarrje ndaj kundërvajtjes, në pajtim me nenin 18 të këtij ligji;

3) nuk vepron ndaj konkluzionit nga neni 19 i ligjit;

4) nuk mundëson hyrjen e pandërprerë në çdo hapësirë biznesi, tokë ose mjet transporti të një blerësi ose furnizuesi të caktuar, në pajtim me nenin 19 paragrafi (1) pika 1) e këtij ligji;

5) nuk mundëson shqyrtimin e papenguar të librave ose dokumentacionit tjetër, në pajtim me nenin 19, paragrafi (1), pika 2), e këtij ligji;

6) nuk mundëson marrjen ose mbajtjen e pandërprerë të sendeve, librave, dokumentacionit tjetër, në çfarëdo forme, kopje ose ekstrakte nga librat ose dokumentacion tjetër, në pajtim me nenin 19 paragrafi (1) pika 3), 4) dhe 5) të këtij ligji;

7) nuk mundëson vulosjen e papenguar në pajtim me nenin 19 pika (1) pika 6) të ligjit;

8) shtypjen e vulave të bëra në zbatim të nenit 19 pika (1) pika 6) të këtij ligji;

9) një person i autorizuar ose një punonjës tjetër refuzon të japë sqarime për fakte dhe rrethana të caktuara në pajtim me nenin 19 (1) pika 7) dhe 8) të ligjit;

10) një person i autorizuar ose punonjës tjetër siguron të dhëna të pasakta, të paplota ose të dhëna që mund të mashtrorjnë Komisionin për vendimmarrje ndaj kundërvajtjes në pajtim me nenin 19 paragrafi (1) pika 7) dhe 8) të ligjit; dhe

11) nuk mundëson ushtrimin pa probleme të veprimeve të tjera në pajtim me nenin 19 pika (1) pika 9) të ligjit.

(2) Gjobë në vlerë prej 50 deri 100 euro në kundërvlerë denari për mikro tregtar, gjobë në vlerë prej 100 deri 200 euro në kundërvlerë denari për tregtar të vogël, gjobë në vlerë prej 200 deri 350 euro në kundërvlerë denari për tregtar të mesëm dhe gjobë në vlerë prej 350 deri 500 euro në kundërvlerë denari për tregtar të madh, do t'i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik për veprimet sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(3) Gjobë në vlerë prej 300 deri 500 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje tregtarit individual për veprimet sipas paragrafit (1) të këtij neni.

(4) Gjobë në vlerë prej 300 deri 500 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik për veprimet sipas paragrafit (1) të këtij neni.

### **Përcaktimi i gjobës**

#### **Neni 28**

(1) Gjatë përcaktimit të gjobës, do të merren parasysh:

- 1) pesha e kundërvajtjes;
- 2) kohëzgjatja e kundërvajtjes dhe
- 3) fushëveprimi i shkëljes dhe pasojat e shkaktuara nga kundërvajtja.

(2) Komisioni i vendimmarrjes ndaj kundërvajtjes, gjatë përcaktimit të gjobës, fillimisht përcakton masën bazë të gjobës, e më pas e rregullon atë, duke marrë parasysh rrethanat lehtësuese ose rënduese.

(3) Rrethanat lehtësuese që merren parasysh në përcaktimin e gjobës janë në veçanti:

1) nëse autori i kundërvajtjes ka paraqitur prova se ka ndërprerë veprimet që përbëjnë kundërvajtje në kohën kur Komisioni i vendimmarrjes ndaj kundërvajtjes ka nisur procedurën për kundërvajtje;

2) nëse autori i kundërvajtjes ka bashkëpunuar në mënyrë efektive me Komisionin i vendimmarrjes ndaj kundërvajtjes;

3) nëse praktika e ndaluar e padrejtë tregtare, e cila ndonëse është dakorduar, nuk është zbatuar ende në marrëdhënien afariste.

(4) Rrethanat rënduese që merren parasysh në përcaktimin e gjobës janë në veçanti:

1) nëse Komisioni i vendimmarrjes ndaj kundërvajtjes ka përcaktuar se është kryer kundërvajtja e parashikuar nga dispozitat e këtij ligji, dhe kundërvajtësi vazhdon të kryejë veprën penale ose përsërit kundërvajtjen e njëjtë ose të ngjashme.

2) nëse autori i kundërvajtjes ka refuzuar të bashkëpunojë ose ka penguar Komisionin e vendimmarrjes ndaj kundërvajtjes në zbatimin e procedurës;

3) nëse autori i kundërvajtjes ka ndërmarrë veprime me qëllim të nxitjes së ndërmarrjeve të tjera për të marrë pjesë në kundërvajtje dhe/ose ka ndërmarrë ndonjë masë hakmarrjeje ndaj personave të tjerë juridikë dhe fizikë me qëllim që t'i detyrojë ata të ndërmarrin veprime që paraqesin kundërvajtje.

4) mosveprimi në lidhje me konkluzionin me të cilin Komisioni për vendimmarrje ndaj kundërvajtjes ka pranuar detyrimet e ofruara, në pajtim me nenin 22 paragrafi (2) të këtij ligji.

### **Vjetërsimi**

#### **Neni 29**

(1) Asnjë procedurë për kundërvajtje nuk mund të fillojë ose të kryhet nëse kalojnë:

- tre vjet për kundërvajtje nga neni 27 i këtij ligji dhe
- pesë vjet për kundërvajtje nga neni 26 i këtij ligji.

(2) Afatet e vjetërsisë fillojnë të zbatohen nga dita e kryerjes së kundërvajtjes. Nëse bëhet fjalë për kundërvajtje të vazhduar ose përsëritur, afatet për vjetërsim do të fillojnë të rrjedhin nga dita kur vepra penale ka pushuar.

(3) Sanksioni i shqiptuar për kundërvajtje nuk mund të kryhet nëse nga dita e hyrjes në fuqi të aktvendimit me të cilin përcaktohet ekzistimi i kundërvajtjes kanë kaluar dy vjet.

(4) Vjetërsimi për nisjen e procedurës për kundërvajtje dhe vjetërsimi i ekzekutimit të sanksionit për kundërvajtje do të ndodhë në çdo rast kur të kalojë dyfishi i kohës që kërkohet me ligj për vjetrimin e fillimit të procedurës për kundërvajtjes, respektivisht për vjetrimin e ekzekutimit të sanksionit për kundërvajtje.

## KREU VI PUBLIKIMET

### **Aktvendimet dhe të dhënat e publikuara në ueb faqen e Komisionit të mbrojtjes së konkurrencës**

#### Neni 30

(1) Aktvendimet e Komisionit të vendimmarrjes ndaj kundërvajtjes, si dhe aktgjykimet, përkatësisht aktvendimet e gjykatës dhe raportit vjetor të Komisionit të mbrojtjes së konkurrencës, publikohen në ueb faqen e Komisionit të mbrojtjes së konkurrencës.

(2) Raporti vjetor për punën e Komisionit të mbrojtjes së konkurrencës do t'i dorëzohet Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në pajtim me nenin 26 paragrafi (6) të Ligjit të Mbrojtjes së Konkurrencës, që përmban të dhëna për numrin e kërkesave të pranuar për nisjen e procedurave dhe ankesave për kundërvajtje, si dhe numrin e procedurave të nisura dhe të përfunduara gjatë vitit paraprak, në pajtim me këtë ligj. Për çdo procedurë të përfunduar, raporti përmban përshkrim të shkurtër të çështjes dhe vendimit që është marrë.

(3) Teksti i publikuar i aktvendimit duhet të përmbajë emrat e pjesëmarrësve në procedurë dhe përmbajtjen themelore të aktvendimit.

(4) Të dhënat që janë marrë në pajtim me nenin 13 paragrafi (3), nenin 18 paragrafi (4) dhe nenin 19 paragrafi (4) të këtij ligji nuk do të publikohen.

## KREU VII BASHKËPUNIMI I KOMISIONIT TË MBROJTJES SË KONKURRENCËS ME KOMISIONIN EUROPIAN DHE ORGANET E VENDEVE ANËTARE TË BE-SË DHE NJOFTIMI

### **Bashkëpunimi me Komisionin European dhe organet e vendeve anëtare të Bashkimit European**

#### Neni 31

Komisioni i mbrojtjes së konkurrencës do të bashkëpunojë në vazhdimësi me Komisionin European dhe organet e vendeve anëtare të Bashkimit European në zbatimin e ndalimeve për praktika të padrejta tregtare të vendeve anëtare të Bashkimit European në procedura për identifikimin e praktikave të padrejta tregtare në zinxhirin e furnizimit me produkte bujqësore dhe ushqimore, e në veçanti për shkëmbimin e informacioneve dhe përvojave mbi praktikat më të mira, rastet e reja dhe praktikat e reja të padrejta tregtare, si dhe masat e zbatimit të miratuara

në procedurë për përcaktimin e praktikave të padrejta tregtare dhe ofrimin e ndihmës në procedurat për përcaktimin e praktikave të padrejta tregtare që kanë dimension ndërkuftar.

### **Njoftimi në Komisionin European për punën e Komisionit të mbrojtjes së konkurrencës**

#### **Neni 32**

(1) Komisioni i mbrojtjes së konkurrencës është i detyruar jo më vonë se data 15 mars e çdo viti, me qëllim të informimit në Komisionin European, të dorëzojë Raport vjetor mbi praktikën e padrejta tregtare në marrëdhëniet afariste të blerësve dhe furnizuesve në zinxhirin e furnizimit të produkteve bujqësore dhe ushqimore.

(2) Raporti vjetor i përmendur në pikën (1) të këtij neni, në veçanti, duhet të përmbajë të dhëna për procedurat e nisura dhe të përfunduar për kundërvajtje gjatë vitit paraardhës.

#### **KREU VIII**

#### **DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

### **Harmonizimi i punës së Komisionit të mbrojtjes së konkurrencës**

#### **Neni 33**

(1) Statuti dhe aktet e tjera të përgjithshme të Komisionit të mbrojtjes së konkurrencës respektojnë dispozitat e këtij ligji në afat prej 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Komisioni i mbrojtjes së konkurrencës është i detyruar që brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji të harmonizojë veprimtarinë, organizimin dhe funksionimin e tij në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

### **Harmonizimi i funksionimit të furnizuesve dhe blerësve**

#### **Neni 34**

Furnizuesit dhe blerësit që kanë lidhur marrëveshje për furnizimin e produkteve bujqësore dhe ushqimore deri në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të respektojnë dispozitat e këtij ligji, në afat prej gjashtë muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

### **Akti nënligjor**

#### **Neni 35**

Lista e produkteve bujqësore dhe ushqimore do të miratohet në afat prej tre muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

### **Zbatimi i prolonguar**

#### **Neni 36**

Dispozitat e nenit 2 paragrafi (1) të këtij ligji në lidhje me shitjen e produkteve bujqësore dhe ushqimore ku blerësi dhe furnizuesi janë të themeluar në vendet anëtare të Bashkimit European ose në vendet e treta, si dhe nenet 31 dhe 32 të këtij ligji do të zbatohen në ditën e aderimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin European.

### **Hyrja në fuqi**

#### **Neni 37**

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga botimi në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

---